



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Bi. Prot. <u>01-699/14</u>
Nr. i ftoq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>26-02-2014</u>
Nr. pages	PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.02.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2431/13, për z. Fatmir Morina – Drejtor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-2431/13, për zyrtarin e lartë z. Fatmir Morina – Drejtor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “D.P.H. Gjahtari”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Morina, fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimi të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet dhe me ndryshimet që duhet t'i bëj për të shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit. Në këtë takim ai ka konfirmuar se në cilësinë e zyrtarit të lartë ushtron funksionin e Drejtorit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe është pronar në biznesin privat “Gjahtari”.

Zyrtari i lartë publik ka kuptuar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik, prandaj pas rekomandimit të Agjencisë, ka premtuar se do ta shuaj biznesin.

Ndërkohë, z. Morina, ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 564/14) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka shuar biznesin privat.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatohet se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

